



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 28.10.2020,
duke filluar në orën 13:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Egzon Azemi, Fadil Gashi, Vala Peshku, Sami Boroci dhe Genc Sherifi.

Mungoi: Blerand Stavileci.

Të pranishëm ishin edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Eroll Raskova, udhëheqës i Sektorit të buxhetit dhe financave, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Leutrim Retkoceri, anëtar i Kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, kryesuesi tha se pika e nëntë **“Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të “Bau Holding”, Bajram Gashianit, Mexhid Dobrës, Isa Gacaferit, Valdrin Bekës, Vjollca Limanit, Kushtrim Maliqit, Shkurte Rizanit, Mentor Zeqirit, Mensur Zeqirit dhe Melihate Zeqirit duhet të hiqet, sepse ka ndryshime. Njëherësh, drejtori i Mirëqenies Sociale, z. Dren Kukaj, propozoi të futet si pikë e rendit të ditës për Kuvend “Propozimvendimi për subvencionimin e shërbimeve direkte për komunitetet e margjinalizuara”.**

Egzon Azemi u shpreh i pajtimit që të futet ky propozimvendim si pikë për seancën e radhës dhe propozoi të ndahen pikat e rendit të ditës në dy pjesë.

Anëtarët e Komitetit u pajtuan që këto pika të rendit të ditës të ndahen për dy seanca.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

REND I DITËS:

Faqe 1 nga 5

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik – 30 shtator 2020 (TM3);
3. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Projektregulloren për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve;
4. Propozimvendimi për miratimin e Planit komunal të veprimit për efikasitet të energjisë (PKVEE) 2019-2021;
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Gëzim (Sabri) Thaçit dhe Sevdail (Bajram) Dakut;
6. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së profesorit Anton Çetta;
7. Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes “Kalabria”, pjesa e kolektorit;
8. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike Banesore, në Prishtinë;
9. Propozimvendimi për subvencionimin e shërbimeve direkte për komunitetet e marginalizuara;
10. Të ndryshme.

Pika e parë.

Miratimi i ekstraktit të procesverbaleve të mbledhjes së katërt dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes së katërt dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik – 30 shtator 2020 (TM3).

Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik – 30 shtator 2020 (TM 3) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tretë

Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Projektregulloren për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Projektregulloren për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërt

Propozimvendimi për miratimin e Planit komunal të veprimit për efikasitet të energjisë (PKVEE) 2019-2021;

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e Planit komunal të veprimit për efikasitet të energjisë (PKVEE) 2019-2021, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Gëzim (Sabri) Thaçit dhe Sevdail (Bajram) Dakut;

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Gëzim (Sabri) Thaçit dhe Sevdail (Bajram) Dakut dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së profesorit Anton Çetta.

Fadil Gashi pyeti lidhur me vendosjen e shtatores.

Genc Bashota dha sqarime, duke cekur se vendosja e shtatores do të realizohet pas përfundimit të parkingut nëntokësor, atje ku është edhe shtatorja e Fehmi Aganit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së profesorit Anton Çetta dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", pjesa e kolektorit.

Vala Peshku pyeti se me këtë propozimvendim a po e rregullojmë zgjidhjen e nyjës në lagjen "Kalabria" për ta rregulluar kolektorin.

Genc Bashota dha sqarime, duke cekur se aty ka prona private në rrugë dhe ato duhet shpronësuar, por megjë nuk kemi mundësi me i shpronësuar, atyre do t'u mundësohet

dhënia e koeficientit. Kjo është e vetmja mundësi për t'i shpronësua këto prona. d.m.th. ju kemi dhënë koeficient. Kjo ka kaluar një herë në Kuvend dhe për këtë janë mbajtur konsulta paraprake, vërejtje ka pasur por në fund krejt janë rregulluar. Koeficienti është 2.4, unik për të gjithë ata që janë përreth kolektorit. E vetmja mundësi që kjo puna e kolektorit të zgjidhet si projekt, është që të transferohen koeficientet, d.m.th. me i transferuar me koeficiente e jo me para.

Egzon Azemi pyeti se a po rritet koeficienti 2.

Genc Bashota u përgjigj, duke thënë se të gjithë e kanë 2.4 koeficientin. Në pjesën e Komunës ka mbetur një shkollë, ndërsa në pronën private një çerdhe.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", pjesa e kolektorit, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike Banesore, në Prishtinë.

Vala Peshku theksoi se nuk e kam të qartë a Ndërmarrjes Publike Banesore po i jap dikush pronën në shfrytëzim apo çka.

Kryesuesi tha se Komuna po e jep në shfrytëzim pronën komunale për nevojat e Ndërmarrjes Publike Banesore, gjegjësisht sistemimin e makinerisë për punë dhe materialin e nevojshëm, i cili do të përdoret për rregullimin e infrastrukturës së qytetit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike Banesore, në Prishtinë, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për subvencionimin e shërbimeve direkte për komunitetet e marginalizuara.

Kryesuesi tha se është një listë e organizatave, ku është edhe shuma e mjeteve që u ndahen atyre organizatave.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për subvencionimin e shërbimeve direkte për komunitetet e marginalizuara dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Të ndryshme

Vala Peshku ceku çështjen e mosfunksionimit të e-maileve zyrtare të asamblastëve.
Kryesuesi e sugjeroi Shërbimin e Kuvendit që të bëjë kërkesë për rritjen e kapacitetit të e-maileve të asamblastëve.

Po ashtu, informoi se ka kërkuar për laptopë rritjen e kapacitetit, ka filluar procedura e shtimit të megabajtëve, kështu që është në procedurë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:25 .

**Procesmbajtësja
Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta**

